



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
MINISTRI

Nr. 10832 Prot.

Tiranë, më 16.12.2015

UDHËZIM
Nr. 53, datë 16.12.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 37, DATË 05.10.2015 "PËR PROCEDURËN E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË DHE TË DYTË, TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET PRIVATE TË ARSIMIT TË LARTË, SI DHE PËR TRANSFERIMIN E STUDIMEVE NË PROGRAMET E STUDIMIT TË OFRUARA NGA KËTO INSTITUCIONE, PËR VITIN AKADEMIK 2015 - 2016", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

1. Në pikën 3 të Udhëzimit nr. 37, datë 05.10.2015, datat "23 Tetor 2015" dhe "13 Nëntor 2015" ndryshohen në "21 Dhjetor 2015",
2. Në pikën 5 të Udhëzimit nr. 37, datë 05.10.2015, datat "6 Nëntor 2015" dhe "27 Nëntor 2015" ndryshohen në "28 Dhjetor 2015",
3. Në pikën 5 të Udhëzimit nr. 37, datë 05.10.2015, datat "7 Dhjetor 2015" dhe "28 Dhjetor 2015" ndryshohen në "28 Janar 2016",
4. Në pikën 6 të Udhëzimit nr. 37, datë 05.10.2015, datat "28 Dhjetor 2015" dhe "15 Janar 2015" ndryshohen në "1 Shkurt 2015",
5. Për zbatimin e këtij Udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve, si edhe institucionet private të arsimit të lartë.

Ky Udhëzim hyn në fuqi dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 23, AL-1001, Tiranë
Tel: +355 4 2225457

Web site: www.arsimi.gov.al